



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 22, datë 17.03.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "PARKU FOTOVOLTAIK
BLUE 1", "PARKU FOTOVOLTAIK BLUE 2" DHE "INFRASTRUKTURA E LIDHJES
ME RRJETIN ELEKTRIK", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërisë "Matrix Konstruksion" sh.p.k dhe "Blessed Investment" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Parku fotovoltaik Blue 1", "Parku fotovoltaik Blue 2" dhe "Infrastruktura e lidhjes me rrjetin elektrik", me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekte zhvilluese shoqëritë "Matrix Konstruksion" sh.p.k dhe "Blessed Investment" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi
3. Dokumentet e Lejeve të Ndërtimit i jepen subjekteve kërkuuese veçmas për "Parkun fotovoltaik Blue 1", "Parkun fotovoltaik Blue 2" dhe "Infrastrukturën e lidhjes me rrjetin elektrik", vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASHTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

